

Rregulla të reja të çmimeve për reklamim të paguar politik

Shkpu, 17 shtator 2021 – Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale i informon radiodifuzerët që me sjelljen e ndryshimeve të reja dhe plotësimin e Kodit zgjedhor (Gazeta zyrtare nr.215 nga 16.09.2021) përcaktohet mënyrë e re të listave të çmimeve për emetimin reklamimit të paguar politik (PPP) i cili do të aplikohet dhe për Zgjedhjet lokale 2021, për shkak të të cilave është paraparë afati shtesë për dorëzimin e listave të çmimeve .

Sipas ndryshimve në nenin 75-gj të Kodit zgjedhor, transmetuesit duhet vetë të përcaktojnë çmimin mesatar (mestarja aritmetike) me sekonda gjatë njëditënite, e marrë sipas reklamuesëve të ndryshëm të çmimeve periudhave kohore për emetim PPP, dhe: Periudha 1- nga 00:00 deri në ora 08:00, Periudha 2 – nga 08:00 deri në ora 16:00 dhe Periudha 3 – nga 16:00 deri në ora 24:00, nuk duhet të tejkalojë çmimin mesatar për reklamimin e secilit prej transmetuesëve veç e veç, të llogaritur në pesë ciklet e fundit të zgjedhjeve të mbajtura në nivelin e gjithë territorit të shtetit.

Transmetuesit e regjistruar më parë në KSHZ nuk duhet të paraqesin kërkesa të reja, të obliguar janë të paraqesin çmimore të reja (të korigjuara). Të gjithë transmetuesit e tjerë që nuk janë më parë të regjistruar në Regjistrin e KSHZ-së, kanë të drejtë të paraqesin kërkesë të re deri të KSHZ-ja dhe të regjistrohen për PPP. Afati për regjistrim dhe dorëzimin e listave të çmimeve është deri më 19 shtator (e diel) deri më ora 24:00 , sipas së cilës Komisioni shtetëror për zgjedhje duhet të konfirmojë dhe shpallë listat e çmimeve.

Transmetuesit të cilët me kohë nuk veprojnë sipas ndryshimeve

të reja ligjore, humbasin të drejtën të regjistrohen për reklama politike me pagesë.